



**Kolegji AAB**

CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI!

**KODI ETIK I KËRKIMIT SHKENCOR  
i Kolegjit AAB**



## Preambula

Kërkimi/hulumtimi është sfida për dijet e përftuara falë të menduarit dhe studimit sistematik, vëzhgimit dhe eksperimentimit<sup>1</sup>, apo një punë e vazhdueshme e ndërmarrë dhe e realizuar në mënyrë sistematike, që ka për qëllim shtimin dhe zhvillimin e njohurive shkencore. Disiplina të ndryshme mund të përdorin qasje të ndryshme, por ato i bashkon motivimi për të zhvilluar të kuptuarit e vetes sonë dhe të botës ku jetojmë. Prandaj, ky Kod i Kërkimit dhe kode të tjera europiane, vlejné për kërkime në të gjitha fushat shkencore dhe studimore.

Kolegji AAB, i vetëdijshëm për funksionin e rëndësishëm shoqëror që ka, njeh parimet themelore dhe vlerat e përbashkëta etike me komunitetin shkencor ndërkombëtar, në bazë të kërkimit shkencor dhe teknologjik, mësimdhënies dhe çdo aktiviteti tjetër universitar. Për këtë arsye, AAB promovon një nivel të lartë të përgjegjësisë në angazhimin shkencor, mësimdhënës e social, duke e konsideruar etikën në kërkimin shkencor si vlerë themelore për realizimin e misionit dhe vizionit institucional; për të promovuar meritë dhe përsosmëri, shkëmbime dhe bashkëpunim me komunitetin shkencor ndërkombëtar si dhe, për krijimin e një mjedisi profesional, të hapur dhe të dinjitetshëm në të gjitha aspektet e saj.

Interpretimi i vlerave dhe parimeve që rregullojnë kërkimin, mund të ndikohet nga zhvillimet sociale, politike ose teknologjike dhe nga ndryshimet në mjedisin e kërkimit. Për këtë arsye, një kod etik i kërkimit shkencor është një dokument dinamik dhe që përditësohet vazhdimisht.

## Parime të përgjithshme

### Neni 1

Kodi ka për qëllim që të ofrohet si një kornizë për vetërregullim për komunitetin shkencor, të sigurojë udhëzime dhe përgjegjësi të qarta për këdo që kryen hulumtime *në* ose *për* AAB-në, për të siguruar që ata janë në gjendje të përmbushin përgjegjësitë e tyre sipas standardeve etike, ligjore dhe profesionale. Kodi përcakton detyrimet për studiuesit *në* dhe *për* AAB-në në të gjitha disiplinat, të jenë të vetëdijshëm për politikën që rregullojnë kërkimin shkencor në këtë institucion dhe të zbatojnë kërkesat institucionale dhe rregullatore.

### Neni 2

Kodi është i përshtatshëm dhe i aplikueshëm për të gjithë stafin akademik dhe shkencor në AAB, botimet e AAB-së, autorë apo vizitorë të angazhuar si dhe për studentët që përfshihen në hulumtime; për projekte kërkimore të financuara nga Kolegji AAB, nga financime publike, grante apo bashkëpunime ndërkombëtare, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet rregullatore institucionale, udhëzimet kërkimore profesionale dhe kornizat ndërkombëtare të etikës së kërkimit shkencor.

---

<sup>1</sup> Preambula e këtij Kodi është mbështetur edhe në parimet e preambulës së Kodit Europian të Sjelljes për Integritetin e Kërkimit [https://ec.europa.eu/research/participants/data/ref/h2020/other/hi/h2020-ethics\\_code-of-conduct\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/research/participants/data/ref/h2020/other/hi/h2020-ethics_code-of-conduct_en.pdf)



### Neni 3

Ky Kod është përpiluar në përputhje me parimet e përcaktuara etike të kërkimit shkencor, praktikat pozitive etike nga universitete europiane<sup>2</sup>, Kodi i Sjelljes për Rekrutimin e Studiuësve<sup>3</sup>, Kodi European i Sjelljes për Integritetin e Kërkimit<sup>4</sup>, Parimet Etike të Psikologëve dhe Kodi i Sjelljes – Apa Style<sup>5</sup>, Komiteti i Etikës së Publikimit (COPE)<sup>6</sup>.

Kodi Etik është i një rëndësie të veçantë në kërkimin biomjekësor që përfshijnë inde e qenie njerëzore në të cilat rezultatet mund të ndikojnë në statusin dhe reputacionin e individëve. Përveç këtij Kodi dhe rregulloreve në fuqi, studiuesit nxiten fuqimisht që t'u përmbahen edhe rregullave dhe standardeve etike të njohura ndërkombëtarisht që vlejnë për fushat e tyre specifike të kërkimit.

### Neni 4

Secila prej zotimeve dhe rregullave të mëposhtme në këtë Kod vendos përgjegjësi të caktuara për stafin, kërkuesit shkencorë, mentorët, bashkëpunëtorët dhe studentët që kryejnë kërkime apo trajnime në AAB, për AAB-në apo, të financuara nga AAB-ja.

## Liria akademike dhe integriteti akademik

### Neni 5

Liria akademike është liria për mësimdhënie dhe për të ndjekur dije dhe kërkim pa ndërhyrje të paarsyeshme ose kufizim nga ligji, rregullore institucionale ose presione publike. Elementet themelore të saj përfshijnë lirinë e studiuësve për të hulumtuar ndonjë temë që ngjall shqetësim intelektual, të paraqesë gjetjet, të publikojë të dhëna dhe përfundime pa kontroll ose censurë, si dhe, të japë mësim në mënyrën që ai e konsideron më të përshtatshme.

Njëkohësisht, integriteti dhe përgjegjësia në drejtimin e një kërkimi shkencor, është bazament i çdo aktiviteti akademik dhe shkeljet e standardeve të kërkimit paraqesin vepra serioze ndaj të gjithë komunitetit shkencor që promovojnë ekselencën në Europë.

Sipas Ligjit të Arsimit të Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, personeli akademik i bartësve të licencuar dhe të akredituar gëzon lirinë për të publikuar rezultatet e kërkimeve të tij, por duke iu nënshtruar rregullave të bartësit lidhur me shfrytëzimin e të drejtave të pronës intelektuale në dobi të bartësit dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

### Neni 6

Integriteti akademik nënkupton përkushtimin ndaj vlerave të ndershmerisë, besimit, drejtësisë, respektit, përgjegjësisë, ligjshmërisë dhe shpërndarjes.

---

<sup>2</sup> Universiteti i Lubjanës [https://www.uni-lj.si/university/code\\_of\\_ethics/](https://www.uni-lj.si/university/code_of_ethics/)

Universiteti i Bolonjës: <https://www.unibo.it/it/ateneo/chi-siamo/codice-etico-e-di-comportamento>

London School of Economics: <https://info.lse.ac.uk/staff/services/Policies-and-procedures/Assets/Documents/codResCon.pdf>

Universiteti Leicester: <https://www2.le.ac.uk/offices/researchsupport/documents/research-code-of-conduct>

<sup>3</sup> <https://euraxess.ec.europa.eu/jobs/charter/code>

<sup>4</sup> [https://ec.europa.eu/research/participants/data/ref/h2020/other/hi/h2020-ethics\\_code-of-conduct\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/research/participants/data/ref/h2020/other/hi/h2020-ethics_code-of-conduct_en.pdf)

<sup>5</sup> <https://www.apa.org/ethics/code>

<sup>6</sup> <https://publicationethics.org/>



Për të mbështetur integritetin akademik, ne jemi të përkushtuar për:

- a. Ruajtjen e standardeve më të larta të integritetit të kërkimit shkencor në të gjitha aspektet e kërkimit;
- b. Sigurohemi se hulumtimi kryhet sipas kornizave, detyrimeve dhe standardeve përkatëse etike, ligjore dhe profesionale;
- c. Mbështesim një mjedis kërkimor i bazuar në një kulturë integriteti, menaxhim të mirë, praktikat më të mira dhe mbështetje institucionale për zhvillimin e stafit dhe studiuesve;
- d. Përdorimi i proceseve transparente, të forta dhe të drejta për t'u marrë me pretendimet e sjelljeve të gabuara të kërkimit shkencor nëse lindin ato;
- e. Punojmë së bashku për të forcuar integritetin e kërkimit shkencor dhe rishikimin e rregullt dhe të hapur të progresit.
- f. Integriteti dhe profesionalizmi nënkupton edhe:
  - sjellje në mënyrë etike dhe me përgjegjësi;
  - saktësi të rezultateve;
  - shmangie nga konflikti i interesit;
  - ruajtje e dinjitetit, sigurisë, mirëqenies të personave që janë përfshirë në hulumtim ose të personit që e mentoroni.

## **Ndershmëria në kërkime**

### **Neni 7**

Aktivitetet kërkimore bazohen në lirinë e kërkimit, lirinë akademike, profesionalizmin, integritetin akademik e personal dhe ndershmërinë e kërkimit.

### **Neni 8**

Ndershmëria e kërkimit përfshin respektimin e vazhdueshëm të autorësisë, njohjen e saktë dhe citimin e arritjeve shkencore të studiuesve të tjerë; përdorimin e vazhdueshëm të metodave të duhura kërkimore dhe ekzaminimin/testimin objektiv të hipotezave shkencore; interpretimin e drejtë dhe profesionalisht të pashtrembëruar të rezultateve dhe, raportimin e sinqertë të gjetjeve dhe të të dhënave.

### **Neni 9**

Metodat, hipotezat, rezultatet e hulumtimit, duhet të jenë të hapura për shqyrtim dhe debat, përveç nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ndonjë kontratë që kërkon konfidencialitet.

### **Neni 10**

Kërkuesi shkencor duhet të dëshmojë se është i familjarizuar me natyrën e hulumtimit kur aplikon në fonde të jashtme shkencore në emër të AAB-së; të koordinohet me zyrën përkatëse të kërkimit shkencor dhe, të dëshmojë se s'ka konflikt interesi apo përfitime të personale në emër të institucionit.



### Neni 11

Çdo studiues që është nënshkruar në një aplikim për financim, qoftë i financuar nga AAB apo fonde jashtë AAB-së, duhet të sigurojë se informacioni i paraqitur është i qartë e i saktë dhe do të mbahet përgjegjës për çdo plagjiaturë (përfshirë vetë-plagjiaturën), trillim, falsifikim ose shtrembërim.

### Neni 12

Kur një aplikim përfshin punë bashkëpunuese me individë dhe organizata jashtë AAB-së, kërkuesi shkencor duhet të sqarojë kostot e bashkëpunëtorit dhe çdo letër mbështetëse ose marrëveshje duhet të jetë transparente dhe e monitorueshme nga institucioni.

## Veprime të papranueshme

### Neni 13

Sjelljet e papranueshme përfshijnë pikat e mëposhtme (lista nuk është shteruese):

- a. Fabrikim, falsifikim, mashtrim: krijimi i të dhënave false ose aspekte të tjera të kërkimit shkencor, përfshirë dokumentacionin dhe pëlqimin e pjesëmarrësve;
- b. Manipulim të papërshtatshëm ose përzgjedhje e të dhënave, imazheve, citimeve të tjetërkujt, apo ndonjë lloj tjetër i sjelljes mashtruese;
- c. Plagjiatura: Kjo përfshin kopjimin ose shpërdorimin e ideve, teksti, programi, ose të dhëna/rezultate ose ndonjë kombinim i tyre, pa lejen dhe citimin e duhur. Studiuesit inkurajohen fuqimisht për të rënë dakord paraprakisht me çdo bashkautor ose kontributdhënës në studim;
- d. Vetë-plagjiatura (prezantimi i një vepre të botuar më parë sikur të ishte i ri)<sup>7</sup>. Kjo më shumë konsiderohet sjellje e gabuar në qoftëse kemi të bëjmë me një ripërpunim dhe përditësim sipërfaqësor, por duke e prezantuar si produkt tërësisht i ri shkencor;
- e. Keqprezantimi/keqinterpretimi i të dhënave/rezultateve me ose pa vetëdije, nga pakujdesia ose duke duke paraqitur një interpretim të gabuar të të dhënave;
- f. Dyfishim i publikimit, përfshirë kopjimin e pazbuluar gjatë dorëzimit të dorëshkrimeve për botim;
- g. Mosdeklarimi i konfliktit të interesit, përfshirë mosdeklarimin e interesave materiale ose të studiuesit ose të financuesve të hulumtimit, përfshirë dështimin për të shpalosur faktin që hulumtimi është i financuar nga ndonjë subjekt;
- h. Prezantim i gabuar/rrejshëm i kualifikimeve a përvojës shkencore;
- i. Keqprezantim i përfshirjes autoriale, siç janë pretendimet e papërshtatshme për autorësinë ose mohimi i autorësisë a kontributit;
- j. Keqpërdorimi akademik i apo keqorientimi i kandidatëve (i temës) të masterit nga ana e mentorit;

---

<sup>7</sup> American Psychological Association (2010) *The Publication Manual of the American Psychological Association. Sixth Edition*, f. 170.



## Respektimi i Kodit

### Neni 14

Stafi i angazhuar në kërkim shkencor dhe personeli vizitues duhet të familjarizohen me këtë Kod dhe dispozitat e tij dhe, të sigurojnë se ata dhe të tjerët që punojnë përreth tyre, janë njoftuar me parimet e Kodit dhe t'u përmbahen këtyre dispozitave.

### Neni 15

Stafi përgjegjës për mësimdhënien ose mbikëqyrjen e studentëve që realizojnë një kërkim apo mentori i temave pasdiplomike, duhet të sigurojnë që këta studentë janë të informuar me parimet thelbësore të Kodit.

### Neni 16

Stafi i ri shkencor duhet të kërkojë të njihet me dispozitat e këtij Kodi apo të këshillohet me kolegët me përvojë.

### Neni 17

Kërkuesi shkencor, mentori i një disertacioni, drejtuesi i një projekti kërkimor etj., tregon gatishmëri për monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së tij kërkimore që drejton apo në të cilën merr pjesë. Ai bashkëpunon me monitoruesit dhe vlerësuesit institucionalë a profesionalë gjatë realizimit të këtyre aktiviteteve shkencore apo mentoruese.

### Neni 18

Shkelësit e këtij Kodi, studiuesit, do t'i nënshtrohen procedurave disiplinore të parashikuara me Rregulloren e Kodit të Sjelljes të AAB-së, rregulloreve përkatëse apo përgjegjësisve të parashikuara sipas kodeve ndërkombëtare të lartpërmendura dhe kontratës së punës.

### Neni 19

Shqyrtimi disiplinor për shkelësin e Kodit janë veprime neutrale, të argumentuara, duhet të kryhen shpejt dhe plotësisht dhe në mënyrë të drejtë. Konfidencialiteti do të ruhet gjatë gjithë fazës dhe askush nga të dyshuarit për sjellje të pahijshme hulumtuese nuk do të viktimizohet.

### Neni 20

Stafi duhet të përmbahet nga deklarime a denoncime publike-mediatike për nivelin ndoshta jo të kënaqshëm të ndonjë bashkëpunëtorit të përfshirë në projekt kërkimor, apo deklarime përçmuese për studentët.

### Neni 21

Institucioni mbron personelin nga akuzat të cilat janë të djallëzuara, joserioze dhe dashakeqe ose të pakujdesshme apo tërësisht pa substancë. Do të ndërmerren veprime të duhura kundër çdo personi që konstatohet se ka bërë një pohim dashakeq ose të pamatur.



## **Neni 22**

Studiuesit për të cilët konstatohet se nuk kanë kryer sjellje të gabuar kërkimore, do të mbështeten dhe ndërmerren hapat e duhur për të rikthyer reputacionin e tyre.

## **Mbikëqyrja e projekteve**

### **Neni 23**

Institucioni ndjek një politikë të qartë për hartimin dhe zbatimin e projekteve kërkimore në bashkëpunim me organizma të tjerë shkencorë, e cila kërkon arritjen e marrëveshjeve para fillimit të zbatimit të projektit. Marrëveshjet mbulojnë aspektet e menaxhimit financiar, mbrojtjen e pronësisë intelektuale, të drejtën e autorësisë, respektimin e origjinalitetit krijues (shmangien e plagjaturës), sigurimin e botimit dhe shpërndarjes së rezultateve të kërkimit shkencor, miratimin paraprak etik dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

### **Neni 24**

Mbikëqyrja etike duhet të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në: politikat për miratimin e publikimit, publikimin për popullatat e cenueshme, kryerjen etike të hulumtimit duke përdorur kafshët, kryerjen etike të kërkimit duke përdorur lëndët njerëzore, trajtimin e të dhënave konfidenciale dhe praktikatat etike të biznesit/marketingut.<sup>8</sup>

### **Neni 25**

Një raport mbi pretendimet për sjellje të gabuara të etikës shkencore dhe rezultatin e tyre, denoncimeve apo shqyrtimeve - kur është e përshtatshme, do të bëhet nga Komisioni i Etikës për çdo vit.

### **Neni 26**

Kodi etik i kërkimit shkencor hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati

---

Dr. Bujar Demjaha, Rektor

---

<sup>8</sup> <https://publicationethics.org/oversight>